



REPUBLICA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 853/3 Prot.

Vlorë më, 24.04.2023

VENDIM

Nr. 20, datë 24.04.2023

PËR
MIRATIMIN PROCEDURËS TË ANALIZËS DHE VLERËSIMIT TË PYETËSORIT
TË VLERËSIMIT TË CILËSISË TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT NËPËRMJET
ALUMNIT

Në mbështetje të nenit 38, neni 103, pika 4 e Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19, të Statutit të Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë, VKM-së Nr 824 si dhe referuar Vendimit Nr 14, datë 10.03.2023 të SA si dhe shkresës nr.777, datë 11.04.2023 të përcjellë nga Zëvendësrektori për kërkimin shkencor dhe zhvillimin insitucional Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 20.04.2023

VENDOSI:

1. Të miratojë procedurën e analizës së pyetësorit të vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit nëpërmjet ALUMNIT, të ndarë në dy faza: (Materiali bashkëlidhur)

Faza e parë: Plotësimi i pyetësorit prej ALUMNI periodikisht një herë në 3 vjet;
Kohëzgjatja: tetor-nëntor.

a) Drejtoria e Edukimit të Ciklit të I&II të studimit, në mënyrë periodike një herë në tre vjet dërgon në adresën e-mail-it të studentëve ALUMNI të diplomuar një vit më parë, linkun e pyetësorit në google forms. Studentët ALUMNI kanë mundësi të plotësojnë këtë pyetësor gjatë muajit tetor-nëntor.

b) Gjatë gjithë procesit të plotësimit të pyetësorëve, Drejtoria e Edukimit për ciklin e Parë dhe të Dytë do të ketë akses në rezultatet e pyetësorëve me qëllim monitorimin e tij. Gjithashtu për të rritur nivelin e përfshirjes do të organizohen prej NJSBCVI dhe Sektori i Këshillimit të Karrierës, ALUMNI dhe aktiviteteve kulturore-sportiv fushata informuese dhe sensibilizuese.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Faza e dytë: Analizimi i rezultateve të pyetësorit të vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit nëpërmjet ALUMNI /Nxjerrja e Rekomandimeve/Publikimi; **Kohëzgjatja: 4 muaj**

a) Brenda 7 muajve pas përfundimit të plotësimit të pyetësorëve prej Alumni ,NJSBCVI përpilon raportin e detajuar të analizës dhe rezultateve të pyetësorit , të cilin e përcjell më tej pranë Komisionit të Sigurimit të Cilësisë së Brendshme në Nivel Institucioni(KSBCI), i cili harton rekomandimet e nevojshme.

b)KSBCI përcjell pranë Rektorit rekomandimet si dhe raportin e analizës së rezultateve të pyetësorëve.

c)Rektori përcjell raportin së bashku me rekomandimet pranë Zv Rektorëve dhe dekanëve,ku këta të fundit e shpërndajnë për t'u vlerësuar dhe zbatuar tek strukturat e varësisë.

d)NJSBCVI publikon raportin e rezultateve të pyetësorit së bashku me rekomandimet e përcjella prej KSBCI,duke respektuar Ligjin Nr.9887 datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr.48/2012 "Për mbrojtjen e të Dhënave Personale.

2.Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Njësitë Kryesore të UV-së, Njësitë Bazë, Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Projekteve dhe Drejtoria e Edukimit të Ciklit të Parë dhe të Dytë të Studimeve.

3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof.Dr. Roland ZISI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
ZV. REKTOR PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL

Nr. 777 Prot.

Vlorë, më 1 / 04 / 2023

Lënda: Projekt - propozim për procedurën e analizës së pyetësorit të vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit nëpërmjet ALUMNI-t.

PROF. DR ROLAND ZISI
KRYETARI I SENATIT AKADEMIK TË UV-së

KËTU

Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, Kreu X, Neni 103, Pika 4 "Njësia e Sigurimit të Cilësisë realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të studimit", në përmbushje të standardeve për Sigurimin e Cilësisë për Institucionet e Arsimit të Lartë, miratuar me VKM Nr. 824, datë 24.12.2021, specifikisht : Standardi I.9, Kriteri 4, Standardi III.10, Kriteri 2, Standardi III.16, Kriteri 6, Standardi V.9, Kriteri 1, Standardi V.9, Kriteri 2, Standardi V.9, Kriteri 3, si dhe në zbatim të Vendimit të Senatit Nr. 14, datë 10.03.2023 për "Miratimin e Pyetësorit të vlerësimit të cilësisë të programeve të studimit nëpërmjet ALUMNIT", në vijim po j'u dërgojmë për shqyrtim dhe miratim prej Senatit Akademik draft-procedurën e analizës dhe vlerësimit të pyetësorit të vlerësimit të cilësisë të programeve të studimit nëpërmjet ALUMNI.

Faza e parë: Plotësimi i pyetësorit prej ALUMNI periodikisht një herë në 3 vjet; Kohëzgjatja: tetor-nëntor.

- a) Drejtoria e Edukimit të Ciklit të I&II të studimit, në mënyrë periodike një herë në tre vjet dërgon në adresën e-mail-it të studentëve ALUMNI të diplomuar një vit më parë, linkun e pyetësorit në google-forms. Studentët ALUMNI kanë mundësi të plotësojnë këtë pyetësor gjatë mujit tetor-nëntor.
- b) Gjatë gjithë procesit të plotësimit të pyetësorëve, Drejtoria e Edukimit për Ciklin e Parë dhe të Dytë do të ketë akses në rezultatet e pyetësorëve me qëllim monitorimin e tij. Gjithashtu për të rritur nivelin e përfshirjes do të organizohen prej NJSBCVI dhe Sektori



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
ZV. REKTOR PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL
i Këshillimit të Karrierës, Alumni dhe aktiviteteve kulturore-sportiv fushata informuese
dhe sensibilizuese.

Faza e dytë: Analizimi i rezultateve të pyetësorit të vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit nëpërmjet ALUMNI / Nxjerrja e Rekomandimeve/ Publikimi; Kohëzgjatja : 4 muaj

- a) Brenda 2 muajve pas përfundimit të plotësimit të pyetësorëve prej Alumni, NJSBCVI përpilon raportin e detajuar të analizës dhe rezultateve të pyetësorit, të cilin e përcjell më tej pranë Komisionit të Sigurimit të Cilësisë së Brendshme në Nivel Institucioni (KSBCI), i cili harton rekomandimet e nevojshme.
- b) KSBCI përcjell pranë Rektorit rekomandimet si dhe raportin e analizës së rezultateve të pyetësorëve.
- c) Rektori përcjell raportin sëbashku me rekomandimet pranë Zv Rektorëve, dhe Dekanëve ku këta të fundit e shpërndajnë për t'u vlerësuar dhe zbatuar tek strukturat e varësisë.
- d) NJSBCVI publikon raportin e rezultateve të pyetësorit së bashku me rekomandimet e përcjella prej KSBCI, duke respektuar Ligjin Nr.9887 datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

ZV. REKTOR

PROF. AS ENKELEJD MËHILLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORI

Vlorë më, 18 . 04 . 2023

Lënda : Ngarkohen për zbatimin e shkresës bashkëlidhur në respektim të legjislacionit përkatës në fuqi :

Drejtuar:

- Senati ✓
- Rektori
- Këshilli Etikës
- Rektori
 - Qendra Studimore e Zhvillimit Rajonal
 - Sektori Juridik
 - Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore
 - Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës
 - Sektori i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun
 - Sektori i IT-së
- Bordi i Administrimit
- Administrator
 - Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse
 - Sektori i Financës dhe Realizimit të Buxhetit
 - Sektori i Prokurimeve
 - Sektori i Shërbimeve
- Njësia e Auditit të Brendshëm
- Zv. Rektor për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin Insitucional
 - Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Projekteve
 - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional
 - Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë
- Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Promovimit Akademik
- Zv. Rektor Akademik
 - Drejtoria e Edukimit për Cildin e Parë dhe të Dytë
 - Sektori i Kurikulave dhe Shërbimit ndaj Studentëve
 - Sektori i Këshillimit të Karrierës Alumni dhe Aktiviteteve Kulturore Sportive
- Sektori i Bibliotekës Shkencore

- Prof. Asoc. Aurela Saliaj Dekan F.SH.
 - Kryesekretare F.SH.
- Prof. Dr. Albert Qarri Dekan F.E.
 - Kryesekretare F.E.
- Prof. As. Armela Panajoti Dekan F.SH.H.D.
 - Kryesekretare F.SH.H.D.
- Prof.As. Hajdar Kicaj Dekan F.SH.T.N.
 - Kryesekretare F.SH.T.N.

~~REKTORI~~
Prof. Dr. Roland ZISI